

SHPALLJE PËR SHPREHJE INTERESI TË KANDIDATËVE TË INTERESUAR PËR T'U ZGJEDHUR SI KOORDINATOR KUNDËR KORRUPSIONIT NË INSTITUCIONET KU ËSHTË KRIJUAR KY POZICION

Me VKM nr.436, datë 26.06.2024 “Për krijimin, organizimin e funksionimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit” është krijuar Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit pranë Ministrit të Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin (në cilësinë e Koordinatorit Kombëtar kundër Korrupsionit) (në vijim Ministri).

Ky institucion ka si mision të punës së tij të sigurojë parandalimin e goditjen e korrupsionit në institucionet e administratës shtetërore/entet publike/shoqëritë tregtare me kapital shtetëror.

Sipas VKM nr.436, datë 26.06.2024 është krijuar pozicioni i koordinatorit kundër korrupsionit në disa institucione, ente publike dhe shoqëri tregtare me kapital shtetëror.

Në zbatim të VKM nr.436, datë 26.06.2024, Kreu IV nën titullin “Koordinatorët kundër korrupsionit”, pika 1 dhe 2 dhe të Rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit”, miratuar me Urdhërin e Ministrit nr. 03, datë 4.06.2025, Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit (këtu e në vijim DPAK) publikon në faqen e saj zyrtare njoftimin për paraqitjen e shprehjes së interesit për t’u zgjedhur/emëruar në pozicionin e koordinatorit kundër korrupsionit, përkatësisht për institucionet e përcaktuara në Aneksin nr.1, pjesë integrale e kësaj shpallje.

1. Aplikanti që shpreh interesin për të aplikuar për pozicionin e koordinatorit kundër korrupsionit në institucionet e renditura në Aneksin nr.1, duhet të plotësojë kushtet/kriteret e mëposhtme:

KRITERET E PËRGJITHSHME

- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- Të mos jetë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale;
- Ndaj tij të mos jetë marrë masë disiplinore e largimit nga puna, që nuk është shuar sipas legjislacionit në fuqi;
- Të mos ketë konflikt interesi në ushtrimin e detyrës, në përputhje me legjislacionin e konfliktit të interesave;
- Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë atë të kryejë detyrën përkatëse;
- Të mos ketë çështje nën hetim/gjykim të nisura ndaj tij.

KRITERET E POSAÇME

- Të zotërojnë diplomë të nivelit “Master i shkencave”, apo “Master profesional”, të përfituar në fund të studimeve të ciklit të dytë me 120 kredite dhe kohëzgjatje normale 2 vite akademike, në një nga degët e arsimit të lartë, sipas përcaktimit në shpalljen publike;
- Të kenë të paktën 2 (dy) vite përvojë pune në profesion.

KRITERI NDALUES

Aplikanti nuk mund të aplikojë si koordinator pranë një institucioni, tek i cili ka qenë i punësuar për një periudhë mbi 3 (tre) muaj të njëpasnjëshëm gjatë tre viteve të fundit.

PËRSHKRIM PËRGJITHËSUES I DETYRAVE TË KOORDINATORIT KUNDËR KORRUPSIONIT

- Koordinatori: i) mbledh informacion për veprimtaritë korruptive, praktikat abuzive, apo arbitrare nga burime të ndryshme dhe kryen hetime administrative; ii) bashkëpunon me strukturat e brendshme të institucionit, entit publik, apo shoqërisë tregtare me kapital shtetëror për shqyrtimin e rasteve të korrupsionit; iii) vlerëson rrezikun e korrupsionit, duke analizuar mundësitë e shfaqjes së formave të veçanta të korrupsionit; iv) harton raportin përfundimtar të rastit, objekt verifikimi, dhe e përcjell atë pranë DPAK-së; v) ndjek e raporton pranë DPAK-së zbatimin e rekomandimeve të marra nga institucioni përkatës; etj.

2. Aplikanti duhet të dorëzojë, nëpërmjet shërbimit postar ose duke u paraqitur fizikisht pranë ambjenteve të DPAK, aplikimin e tij.

Dosja e aplikimit duhet të përmbajë listën e dokumenteve sikurse renditen më poshtë, në format original ose të njehsuar me të (të noterizuar):

- Kërkesë me shkrim për shprehje interesi, duke specifikuar sipas rastit edhe institucionin/et përkatës/e ku shpreh interesin për tu emëruar;
- CV (jetëshkrim), e përditësuar;
- Fotokopje të ID;
- Diplomë e nivelit “Bachelor” dhe “Master shkencor”. Për diploma të marra jashtë vendit, të përcillet njehsimi i diplomës nga Ministria e Arsimit.
- Vërtetim që nuk ka masë disiplinore në fuqi nga institucioni /subjekti privat pranë të cilit rezulton i punësuar;
- Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- Vërtetim të gjendjes gjyqësore (Dëshmi penaliteti);
- Vërtetim nga organi i prokurorisë dhe gjykatës që nuk ka çështje nën hetim/gjykim, të nisur ndaj tij;

- Fotokopje e librezës së punës ku të vërtetohet gjithë eksperiencia e punës;
- Çdo dokumentacion që vërteton, trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, si dhe referenca të përmendura në jetëshkrim;
- Deklaratë personale të nënshkruar, lidhur me vërtetësinë e dokumentacionit të dorëzuar;
- Formularin e vetëdeklarimit (Dekriminalizimit) sipas modelit bashkëlidhur Vendimit nr.17/2016, të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në Ligjin nr.138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.

3. Mosdorëzimi i dokumentacionit të sipërcituar përbën shkak për skualifikimin e aplikantit.

4. Aplikimi për shprehje interesi i paraqitur nga kandidatët, kalon në dy faza vlerësimi, në fazën e verifikimit paraprak të vlerësimit të dokumentacionit dhe më tej në fazën e intervistimit të kandidatit, ku në përfundim të procedurës së konkurrimit do të shpallet fitues çdo kandidat që vlerësohet me minamalisht 60 pikë nga 100.

5. Kandidatët që kanë paraqitur kërkesë për shprehje interesi, do të testohen në lidhje me:

- Ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, "Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar;
- Ligjin nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë"
- Ligjin nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”;
- Ligjin nr. 111/2018 “Për kadastrën”*
- Ligjin nr. 20/2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”*
- Ligji nr.9780/2007, i ndryshuar “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”*
- Ligji nr.99/2024 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”*
- VKM nr. 29, datë 17.1.2024 “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrit të Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin”
- VKM nr. 436, datë 26.06.2024, “Për krijimin, organizimin e funksionimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit”.

*Ligjet e listuara më sipër, në shkronjën d, e dhe f kërkohen vetëm për aplikimet pranë institucioneve: Agjencia e Trajtimit të Pronave; Inspektorati Kombëtar për Mbrojtjen e Territorit; Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura.

6. Afati për paraqitjen e kërkesës për shprehje interesi për pozicionin e punës së koordinatorit në institucionet e renditura në Kreun IV, pika 1 të VKM nr.436/2024, është 7 (shtatë) ditë pune nga publikimi në faqen zyrtare të DPAK. Pas këtij afati aplikimet e ardhura nuk merren në shqyrtim. Për aplikimet e ardhura brenda afatit të përcaktuar në këtë pikë, por që paraprakisht rezultojnë të dorëzuar me dokumentacion të paplotë, kandidati do të njoftohet se ka një afat 5 (pesë) ditë kalendarike nga dita e njoftimit, për plotëmin e tij. Në rast të mosplotësimit të dokumentacionit brenda afatit të lartpërmendur, kandidati përjashtohet nga procedura e konkurrimit.

7. Komisioni pas plotësimit të dokumentacionit, miraton listën përfundimtare të kandidatëve të kualifikuar dhe njofton në mënyrë elektronike kandidatët e skualifikuar së bashku me arsyet përkatëse. Pas përfundimit të afatit të ankimit, dhe shqyrtimit të tyre, Komisioni miraton listën e kandidatëve të kualifikuar dhe vendos datën e intervistës e cila do i komunikohet individualisht secilit kandidat në rrugë elektronike, si dhe do të publikohet në faqen zyrtare të DPAK.

8. Çdo kandidat do të njoftohet në adresën e tij elektronike për rezultatin e vlerësimit dhe pikët e grumbulluara.

9. Komisioni vijon me thirrjen e kandidatëve, për pozicionin e vendit vakant ku kandidati fitues është vlerësuar që të emërohet, duke respektuar për aq sa është e mundur, preferencat e përzgjedhjes fillestare të këtyre kandidatëve.

10. Lista e miratuar me kandidatët fitues, në përfundim të procedurës së konkurrimit, së bashku me pozicionet përkatëse të pranuar publikohet në faqen zyrtare të DPAK.

11. Njoftimet lidhur me procedurën e rekrutimit bëhen në rrugë elektronike, në adresën elektronike të vendosur në jetëshkrimin e paraqitur.

Aneks 1

Nr.	Institucioni
1	Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a.
2	Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore
3	Pronat Shtetërore
4	DVASHK Tirana Jug
5	DVASHK Tirana Rurale II
6	DVASHK Vlorë
7	DVASHK Shkodër (Legalizimit në Shkodër Regj. Në Tiranë)
8	Inspektoriati Kombëtar për Mbrojtjen e Territorit
9	Inspektoriati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore
10	Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial
11	Operatori i Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor
12	Posta Shqiptare
13	Spitali Obstetrik Gjinekologjik “Mbretëresha Xheraldinë”
14	Spitali Universitar Obstetrik Gjinekologjik “Koço Gliozheni”